

PROCESVERBAL
nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 02.05.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Emilija Janevska, mr. Emilija Petreska Kamenjarova, mr. Ivona Mufisheva, dr. Ivana Stojanovska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 25.04.2024.
2. Propozim për iniciimin e procedimit për kundërvajtje kundër TV Alfa për shkelje të nenit 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor.
3. Zgjedhjet presidenciale 2024: Përfaqësimi mediatik zgjedhor në rrethin e parë të fushatës zgjedhore - nga 4 deri më 22 prill.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 25.04.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër TV Alfa për shkelje të nenit 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor. Ai shpjegoi se transmetuesi në pesë raste më 25 prill 2024 ka shkelur nenin 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, sepse në një orë reale për një nga kandidatët për kryetar që hyri në rrethin e dytë, transmetoi më shumë RPP nga 4 minutat e lejuara. Për këtë arsye, propozohet që Këshilli të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente. Ai shpjegoi që Sektori për çështje programore këtë shkelje e ka konstatuar të njëjtën ditë dhe në këtë drejtim shërbimi ka pasur një bisedë telefonike me redaktorët e TV Alfa, pas së cilës media e ka ndërprerë shkeljen. Nga shpjegimi i tyre, keqkuptimi ka ardhur sepse ata mendonin se mund të shfrytëzonin gjysmën e kohës totale prej 9 minutash e 30 sekondash, por sipas Udhëzimit të miratuar nga Këshilli, maksimumi që mund të jipet për RPP për dy kandidatët që hynë në rrethin e dytë është 4 minuta.

Z. Petrushevski shpjegoi se e ka shqyrtuar raportin, ka parë tejkalimin e limitit nga koha e lejuar prej 4 minutash dhe është e qartë se më 25 prill kanë shkelur ligjin, gjë që shihet edhe nga numrat e monitorimit. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin. Ai për median ka thënë se është mirë që e ka korrigjuar gabimin dhe shpreson që deri në fund të zgjedhjeve do ta respektojë Ligjin.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor nr.10-2162/1 të datës 02.05.2024 të SHTR Alfa TV SHPKNJP Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 75-gj paragrafit (1) të Kodit Zgjedhor.

Këshilli njëzëri konkludoi që kundër SHTR Alfa TV SHPKNJP Shkup të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse nga mbikëqyrja u konstatua se në kundërshtim me neni 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, më 25 prill 2024, gjatë kohës së rrethit të dytë të Zgjedhjeve Presidenciale 2024, në orët reale të transmetimit të programit nga ora 08:00 deri në orën 9:00, nga ora 9 deri në orën 10:00, nga ora 10:00 deri në orën 11:00, nga ora 11:00 deri në orën 12:00. dhe nga ora 12 deri në orën 13:00, ka transmetuar më shumë se 4 minuta reklamim të paguar politik për kandidaten për president – Gordana Siljanovska Davkova, mbështetur nga politike partisë në opozitë - VMRO-DPMNE.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Raportin për Zgjedhjet presidenciale 2024: Përfaqësimi mediatik zgjedhor në rrethin e parë të fushatës zgjedhore - nga 4 deri më 22 prill 2024. Ai shpjegoi se përfaqësimi mediatik zgjedhor në 2024, përbëhet nga monitorimi mbi tre shërbimet programore të RTM të Radio Televizionit të Maqedonisë: TVM1, TVM2 dhe kanalit parlamentar, dhe nga shërbimet programore të dhjetë televizioneve komerciale kombëtare: TV Alsat-M; TV Alfa; TV Kanal 5; TV Sitel; TV Telma; TV 21-M; TV Klan Maqedoni; TV Shenja; TV 24 Vesti dhe TV Sonce. Është konstatuar se të gjitha televizionet i kanë respektuar parimet e parashikuara në nenin 75 paragrafi (1) dhe nenin 75-a të Kodit Zgjedhor. Përrjashtim bën vetëm TV 21-M, e cila ka informuar dhe ka respektuar parimet nga neni 75 paragrafit (1) dhe nenin 75-a të Kodit Zgjedhor, por në pajtim me vendimin e tyre editorial, pas së cilës kanë paraqitur edhe raport, ku nuk kanë informuar për kandidatin për kryetar të partisë “E majta”. Arsyetimi që dha TV 21- ka të bëjë me mospranimin e qëndrimeve të promovuara në fushatën për zgjedhjet presidenciale nga kandidati i partisë politike të Majtë gjatë zgjedhjeve

parlamentare, pasi që promovojnë ndërprerjen dhe dajlen e Maqedonisë nga NATO, ndërprerja e Marrëveshjes së Prespës, tërheqja e njohjes së Kosovës e të ngjashme. Shumica e qytetarëve nuk e ndajnë mendimin e tyre sepse janë kundër parimeve demokratike dhe një sjellje e tillë e pahijshme nga kjo parti politike, tha ai ka pasur edhe në institucionin tonë ku disa herë në mënyrë të vrazhdë, të pafytyrë dhe mënyrë të pa përshtatshmi i është drejtuar zyrtarisht AVMU-së. Ai theksoi se informimi i TV 21-M në lidhje me kandidatët e tjerë presidencialë është i duhur dhe kanë pasur parasysh intensitetin e fushatës që kanë pasur kandidatët e tjerë për kryetar.

Z. Ajdini tha se anëtarët e Këshillit gjithmonë kanë diskutuar për raportet pas përfundimit të ciklit zgjedhor dhe e di që gjatë kësaj periudhe punonjësit e Agjencisë kanë një ngarkesë të shtuar të punës. Ai theksoi se në atë drejtim ka pasur komunikim të vazhdueshëm me udhëheqësen Emilija Janevska dhe Emilija Petreska Kamenjarova, me këshilla për mediat që në këto zgjedhje të dyfishta të mos bëjnë ndonjë gabim. Në këtë proces zgjedhor ASHMA, dhe përkundër përkujtimit dhe informimit të mediave, ishte e detyruar nga e para të sqarojë për parimet e barazisë dhe proporcionalitetit dhe se me këto parime mediat nuk mund të manipulojë dhe relativizojë numra dhe motive. Siç thuhet në vetë Raportin, lëndë e analizës ishin edicionet e lajmeve ditore, pra lajmet. Për analizë u veçua edicioni qendror i lajmeve, si dhe debatet dhe intervistat e transmetuara, përmbajtja kryesore e të cilave ishin zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Ai pajtohet me konstatimin që rezulton nga vetë analiza se qasja editoriale e të gjitha stacioneve televizive ishte identike dhe pothuajse të gjitha televizionet e kanë përbushur parimin e Kodit Zgjedhor për trajtim të barabartë mbi përfaqësimin mediatic zgjedhor të kandidatëve për kryetar shteti të parashikuara në nenin 75 paragrafi (1) dhe nenin 75-a të Kodit Zgjedhor. Siç thuhet, TV 21-M pothuajse 90% të këtyre parimeve i ka respektuar, por nuk ka informuar për kandidatin presidencial të së Majtës prof. dr. Biljana Vankovska-Cvetkovska. Në lidhje me këtë, ai tha se TV 21-M transmeton program më së shumti në gjuhën shqipe, por filloi me emisione debatuese që transmetohen në gjuhën maqedonase dhe ditarin, po ashtu që do të thotë se gjuha maqedonase kultivohet, gjegjësisht TV 21-M ka një format dygjuhësh. Kur janë shqyrtuar raportet e mëparshme, ky televizion ka informuar gjithmonë në mënyrë neutrale dhe profesionale, dhe nga institucionet e tjera ndërkombëtare është vlerësuar si televizion neutral dhe i balancuar. Në shpjegimin e tyre se pse nuk i dhanë mundësinë të fliste kandidatit të së Majtës janë renditur disa arsye. Thuhet se pikëpamjet e Prof. Dr. Biljana Vankovska-Cvetkovska thotë se do të revokojë njohjen e Republikës së Kosovës, se është kundër Marrëveshjes së Ohrit, dhe kjo më së shumti shqetëson shqiptarët, e sidomos që është kundër Badenterit dhe balancuesit. Ai deklaroi se nëse do të ishte në vendin e tyre, ndoshta do të kishte vepruar njëjtë. Kjo nuk është mirë sepse gjithçka që është arritur në 20 vitet e fundit në vend, si hyrja në NATO, rruga drejt BE-së, me pikëpamjet e saj i tensionon marrëdhëniet kombëtare në vendin tonë. Në atë pjesë, ai e pranon informacionin ashtu siç është. Ai vuri në dukje edhe një gabim teknik në Raport, ku thuhet "kushtet mediatike" në vend të "shërbimeve mediatike". Në paragrafin e tretë janë numëruar disa kushte që duhen respektuar, njëra prej të cilave është për aksesin dhe trajtimin e pjesëmarrësve në procesin zgjedhor në emisione të veçanta informative, intervista dhe debate. Prandaj, ai mendon që për faktin se nuk trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë kandidatët, prandaj ka mungesë të disa kandidatëve të cilët qëllimisht nuk kanë marrë pjesë në disa emisione, siç është z. Bujar Osmani që nuk ka marrë pjesë në intervistën e TV ALFA, mungesën gjithashtu e anuloi dhe z. Arben Taravari në TV 24 Vesti dhe shembuj të tjerë të ngjajshëm. Ai pyeti, nëse politikanët nuk përfitojnë nga dalja në televizion, kush do të përfitonte më shumë se ata? Pra, ky kusht që është parashikuar në Kodin Zgjedhor dhe në Ligjin për

Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, duhet të analizohet më në detaje. Ai deklaroi se do ta pranonte Raportin ashtu siç ishte bërë.

Z. Fidanoski tha se fushata ende vazhdon si për zgjedhjet presidenciale ashtu edhe për ato parlamentare dhe në fund pas përfundimit të tyre më 8 maj do të bëhet një sublimim gjithëpërfshirës se si ka shkuar e gjitha. Deri më tani ai tha se në përgjithësi mbulon të gjitha aspektet e një fushate reale që i përshtatet një gare zgjedhore pluraliste që duhet të jetë në një shtet demokratik. Ai beson se Këshilli dhe Agjencia me profesionalizëm dhe përgjegjësi e kryejnë punën e tyre, dhe ky është konstatim dhe nga raportet e organizatave të tjera relevante, se në vazhdimësi ASHMA është në krye të detyrës. Raporti për të është i pranueshëm, ai mendon se në mënyrë gjithëpërfshirëse i përmban informacionet për përfaqësimin mediatik zgjedhor të pasqyrimin mediatik në fushatë, se lart-poshtë në përgjithësi janë respektuar parimet e vlefshme të Kodit Zgjedhor dhe beson se kështu dhe do të vazhdojë. Sa i përket konstatimit të dorëzuar në Raport, e cila ka të bëjë me transmetuesin e TV21-M, ai tha se është marrë shpjegim nga transmetuesi se pse në pasqyrimin e fushatës të shtatë kandidatëve për kryetar është anashkaluar një dhe nëse shkohet në përqindja më pak se 15 % praktikisht puna është e papërfunduar. Në shpjegim thuhet se sipas tyre, politika e tyre editoriale, e cila ndan vlerat evropiane, nuk korrespondon me pikëpamjet e shprehura nga kandidati për president, gjë që sipas mendimit të transmetuesit, bie ndesh me standardet dhe vlerat evropiane. Ai deklaroi se është person që i respekton vlerat evropiane dhe dëshiron t'i ndajë ato dhe beson se vetëm në këtë mënyrë Maqedonia do të përfshihet si pjesëtare e familjes evropiane të popujve (kombeve) si familje e vlerave. Ai personalisht beson se TV 21-M edhe jashtë procesit zgjedhor deri më tani ka qenë figurativisht një "raund" i vërtetë i dëshmi apo debateve të mendimeve të ndryshme politike, të kundërshtimit të argumenteve për tema dhe çështje të ndryshme dhe sipas tij, në mënyrën e duhur ka dhënë kontribut të qartë për pluralizmin mediatik që është në Maqedoni. Vlerë evropiane është që të respektohen rregullat dhe procedurat që vlejnë në funksionimin dhe kjo do të thotë të respektohen dhe parimet që përmban neni 75 paragrafi (1) dhe neni 75-a të Kodit Zgjedhor. TV 21-M në shpjegimin e marrë në raportin që është bashkëngjitur në materialin për seancën, theksoi se për zgjedhjet parlamentare synojnë të bëjnë pasqyrim të plotë të raportimit dhe pasqyrimin mediatik të pjesëmarrësve në procesin zgjedhor. Pa u interpretuar si ndërhyrje në politikën editoriale të TV 21-M, i kërkoi Agjencisë, nëse është e mundur, të njoftohet me shkrim transmetuesin se me vigjilencë do të ndiqet në periudhën e ardhshme të fushatës zgjedhore si gjithë të tjerët natyrisht, nëse në të vërtetë ai e bën këtë, nëse i respekton të gjitha parimet që përmban Kodi Zgjedhor, nëse respektohet parimin e proporcionalitetit sipas numrit të listave të konfirmuara, i cili vlen për zgjedhjet parlamentare. Ai ka kërkuar edhe një herë që nëse është e pranueshme nga anëtarët e tjerë të Këshillit, që transmetuesi të njoftohet me shkrim për detyrimet që ka dhe që duhet t'i zbatojë në vepër.

Z. Trajçev tha se plotësisht pajtohet me z. Fidanoski rreth vlerave evropiane që duhet të respektohen dhe për këtë përpigën sepse kjo është shumë e rëndësishme, por pjesë e vlerave evropiane janë edhe respektimi i Ligeve. Si liria e shprehjes dhe demokracia mundësojnë ku ato mekanizma pavarësisht nëse jemi në pajtim apo jo, medium që ka detyrim ligjor nga neni 75 paragrafi (1) dhe neni 75-a i Kodit Zgjedhor për raportim të barabartë, pavarësisht nëse dikush është në pajtim ose jo, ai është i detyruar t'u japë akses të barabartë të gjithëve. Njoftimin nga SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup e kanë marrë sot para seancës dhe ka gjasa që nga shërbimet të dalë ndonjë propozim për sanksion sipas Ligjit. Në lidhje me Raportin për Zgjedhjet Presidenciale 2024: përfaqësimin mediatik zgjedhor në rrethin e parë të fushatës zgjedhore – nga data 4 deri më 22 prill, ai tha se është i detajuar,

se qartë i paraqet të gjitha situatat dhe mendon se deri më tani në këtë fazë të fushatës zgjedhore, mediumet i informojnë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe u japin akses të barabartë të gjithë pjesëmarrësve në fushatë.

Z. Petrushevski tha se personalisht e përkrah propozimin e z.Fidanoski për të informuar apo paralajmëruar mediumin rreth asaj që ka bërë. Ai personalisht nuk e përkrah vendimin që të mos raportohet për kandidaten Cvetkovska dhe lë hapësirë deri në përfundim të zgjedhjeve që edhe një herë të shihet se si do të sillen, nëse do të ketë përmirësim, sepse nga ana e tyre ka njoftim për përmirësim. Në çdo rast, ai tha se nuk e justifikon atë. Ai e përkrah atë që ka propozuar Fidanovski dhe për momentin nuk propozon asgjë tjetër përveç pranimit të informacionit dhe propozimit të kolegut Fidanovski si përfundim i gjithë diskutimit.

Z. Trajçev i bëri pyetje shërbimit, duke konsideruar se rrethi i parë ka përfunduar dhe duhet të shqiptohen masa për kundërvajtje, pyeti nëse tani duhet të shqiptohen apo duhet të kryhen të dyja rrethet, si është e drejtë?

Z. Trajçevski shpjegoi se Ligji nuk shkruan asgjë për këtë, por do të ishte reale që fillimisht të kemi një raport të plotë.

Z. Trajçev tha se pyetja e tij është procedurale sepse në këtë dhe në seancën e kaluar janë shqiptuar masa për kundërvajtje për dy transmetues, pyetja e tij është nëse duhet të presim përfundimin e zgjedhjeve apo duhet të reagojmë menjëherë kur do të konstatohet mos respektim i Ligjit?

Z. Trajçevski shpjegoi se shqiptimi i shkeljes së sotme dhe dy të mëparshmet kanë të bëjnë me shkelje që transmetuesit mund t'i bëjnë në baza ditore, dhe për mënyrën e njoftimit është e nevojshme së paku 10 raporte ditore. Ata kanë detyrimin të raportojnë në mënyrë të balancuar, por jo për një periudhë një ditore, por për një periudhë të një fushate të tërë.

Z. Trajçev tha nëse në atë rast duhet të përfundojë rrethi i parë dhe pastaj të matet apo jo?

Z. Trajçevski tha se fillimisht duhet të merret pasqyrë e plotë. Në Ligj nuk shkruhet se kur, por thuhet se duhet të raportojnë në mënyrë të balancuar dhe të drejtë. Ka shkelje, si tejkalim i limiteve të RPP, keqpërdorim me të miturit në procesin zgjedhor, shkelje në lidhje me mospërshtatjen e një edicioni ditor të lajmeve për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe të ngajshme, për këto nuk ka nevojë për analiza 10 ditëshe, në këto raste reagohet menjëherë. Ndoshta media mund 3 ditë të raportojë për VMRO DPMNE nëse ka më shumë aktivitete, por në ditët në vijim më shumë të raportojë për LSDM-në apo BDI-në varësisht nga intensiteti i fushatave të tyre. Në këtë drejtim, ai u përgjigj se duhet një periudhë më e gjatë kohore për të bërë një vlerësim për mënyrën e informimit.

Z. Fidanoski, në kuadër të diskutimit të fundit, tha se fotografia më e mirë se a është balancuar njoftimi, e kemi pas përfundimit të plotë të ciklit zgjedhor, ndërsa masat e shqiptuara të mëparshme për kundërvajtje ishin për shkelje ditore, njëra për shkelje të heshtjes zgjedhore, të tjerat për mospërshtatjen e programit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara shqisore, këto janë punë konkrete që duhet të reagohet në bazë ditore.

Z. Trajçev tha se në këtë rast kemi të bëjmë për përfundim të rrethit të parë ku nuk mund të korrigohet, nuk është pjesëmarrës në rrethin e dytë ku mund të korrigohet dhe kjo është gjendja faktike e cila do të jetë e njëjtë dhe në fund me Raportin e plotë dhe tani me këtë Raport. Pyetja e tij ishte a do të dalin tani me propozim për procedurë kundërvajtëse për

TV 21-M apo në fund të zgjedhjeve me propozime konkrete për të gjitha shkeljet e konstatuara?

Z. Trajçevski shpjegoi se me marrjen e pasqyrës së plotë për pasqyrim të procesit zgjedhor nga të gjitha mediat si për zgjedhjet presidenciale ashtu edhe për ato parlamentare do të bëhen propozime për procedura të mundshme për kundërvajtje.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska, tha se nëse me shkrim i drejtohet Agjencia transmetuesit, kjo mund të perceptohej si “kërcënim” dhe ndërhyrje në lirinë editoriale. Mediumi tashmë e di se është lëndë e mbikëqyrjes, dhe Agjencia në pajtim me Ligjin ka për detyrë nga dita e shpalljes deri në ditën e përfundimit të zgjedhjeve t’i monitoron transmetuesit. Sepse në Kodin Zgjedhor nuk ka masë paralajmërimi dhe më pas për kundërvajtje, për shkeljet e konstatuara menjëherë shkohet me kundërvajtje, paralajmërimi mund të keqkuptohet.

Z. Trajçevski tha se nuk do të jetë paralajmërim por njoftim drejtuar medias.

Z. Trajçev tha se meqenëse tani ka qëndrime të ndryshme për dorëzim të njoftimit, ai propozoi që të vihet në votim.

Z. Petrushevski tha se gjithësesi propozimin e z.Fidanoski do ta vë në votim.

Z. Fidanoski tha se e ka kuptuar se ku aludon udhëheqësja Janevska dhe për këtë konkretisht ka thënë se me shkrim duhet njoftuar transmetuesi dhe jo të paralajmërohet, dhe t’i thuhet se në të ardhmen pritet që shkelja të mos përsëritet. Në këtë mënyrë ata do të ndërjegjësohen se duhet ta kryejn punën e tyre siç duhet dhe sipas rregullave të lojës elektorale.

Z. Petrushevski propozimin e z. Fidanoski për të njoftuar mediumin më saktë se ku kanë gabuar dhe në pajtim me Kodin Zgjedhor çfarë pritet prej tij në të ardhmen, e vendosi në votim.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin për Zgjedhjet presidenciale 2024: Përfaqësimin mediatik zgjedhor në rrethin e parë të fushatës zgjedhore - nga 4 deri më 22 prill dhe Njoftimin nga SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup 03-2134/1 të datës 30.04.2024 dhe me 4 vota “pro” dhe dy abstenime nga z.Trajçev dhe z.Jançeski konkludoi që t’i dorëzon njoftim me shkrim SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup për konstatimet e monitorimit të këtij shërbimi programor, duke vënë në dukje detyrimin për respektimin e parimeve për informim mediatik të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

